



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 11, datë 4.02.2023

VERIFIKIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	BASHKIA SHKODËR
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP ☒ • Reklamim nga të tretë ☐
Numri i procedurave të verifikuara	1 (një)
Lloji i procedurës/ave të verifikuara	Procedurë ankand publik "E hapur"
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti Shitës nuk ka vepruar në përputhje me kreun II të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, lidhur me përllogaritjen e vlerës fillestare të ankandit, në procedurën e ankandit objekt hetimi administrativ. 2. Autoriteti Shitës nuk ka vepruar në përputhje me nenin 40 të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar dhe kreun V të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, lidhur me hartimin e kriterëve dhe të dokumenteve të ankandit, në procedurën e ankandit objekt hetimi administrativ. 3. Autoriteti Shitës nuk ka vepruar në përputhje me nenin 36 të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar dhe kreun V të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1719, datë 17.12.2008 "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar, lidhur me vlerësimin e dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë fitues, në procedurën e ankandit objekt hetimi administrativ.
Masat e marra	Në bazë të nenit 7, pika 2, gërmat "b" dhe "c", të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar,

	APP vendosi dënimin me gjobë, ndaj 5 personave, anëtarë të njësisë së ankandit, të evidentuar përgjegjës, sipas konstatimeve në këtë vendim.
--	--